



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. G.ba Prot.

Tiranë, më 29/07.2024

VENDIM

Nr. 18, datë 29/07/2024

PËR

“MIRATIMIN E DEKLARATËS SË MISIONIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE
PËR VITET AKADEMIKE 2025-2027”

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 48 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Arteve, neni 48, dhe pasi shqyrtoi Relacionin e Rektoratit “Mbi hartimin e deklaratës së misionit të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2025-2027”, relatuar nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj si dhe VSA nr. 95, datë 09/07/2024 “Për propozimin për miratim të Deklaratës së Misionit të Universitetit të Arteve, për vitet akademike 2025-2027” dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Deklaratës së Misionit të Universitetit të Arteve, për vitet akademike 2025-2027, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ

(Kryetar)



Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)

Jeton SHEHU



(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI



(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir LLAKAJ

(Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2120 Prot.

Tiranë, më 09/07/ 2024

VENDIM

Nr. 95, datë 09/07/ 2024

PËR

**“PROPOZIMIN PËR MIRATIM TË DEKLARATËS SË MISIONIT TË
UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR VITET AKADEMIKE 2025-2027”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1, gërma b të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Arteve dhe pasi shqyrtoi Relacionin e Rektoratit “Mbi hartimin e deklaratës së misionit të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2025-2027”, relatuar nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Propozimin për miratim të Deklaratës së Misionit të Universitetit të Arteve, për vitet akademike 2025-2027, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA


Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

RELACION

Mbi hartimin e deklaratës së misionit të Universitetit të Arteve për vitet akademike
2025-2027

Grupi i punës për menaxhimin Strategjik në Universitetin e Arteve, pas konsultimeve me personelin akademik dhe administrativ në fakultete dhe rektorat, diskutoi rreth materialit përmbledhës, për të konkluduar në një dokument final, konkretisht: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2025-2027*”, dokumenti i cili do t’u paraqitet organeve drejtuese, Bordit të Administrimit (BA) dhe Senatit Akademik (SA), për t’u miratuar.








Grupi i punës për Menaxhimin Strategjik për Universitetin e Arteve, në veprimtarinë e tij, u mbështet në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim.


Në përfundim të diskutimeve të anëtarëve të grupit të punës, u konkludua në hartimin e dokumentit: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2025-2027*”.

Bashkëlidhur: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2025-2027*”.

Grupi i punës:

1. Prof. Kastriot Çausi
2. Prof. Dr. Erald Bakalli
3. Prof. Dr. Isak Shehu
4. Prof. Ilir Martini
5. Prof. Artan Peqini
6. Alma Sinanaj
7. Elia Plaku (Ademi)
8. Adriatik Kraja









Sekretar i GMS



9. Entela Ruka



10. Adela Kusuri



DEKLARATA E MISIONIT E UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR VITET
AKADEMIKE 2025-2027

MISIONI

Universiteti i Arteve edukon artistë të fushës së Muzikës, Artit Skenik dhe Arteve të Bukura bazuar në talent, eksperiencat dhe kualifikimet e trupës akademike me synim arritjen e standarteve më të larta nëpërmjet edukimit individual artistik dhe rritjes së kreativitetit.

Universiteti i Arteve si një institucion publik i arsimit të lartë ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/shkencor;
- b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;
- c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik/shkencor;
- g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë;
- h) të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
- i) të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës;
- j) të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;
- k) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit;
- l) të krijojë gjithë përfshirjen e studentëve vendas dhe të huaj shqipfolës;
- m) të garantojë shprehjen e lirë në programet e tij mësimore të ideve kulturore, artistike dhe shkencore, politike, sindikale e fetare, që janë me karakter artistik, shkencor.

POLITIKA E PROGRAMIT

1. Përshkrimi i programit

Qëllimi i politikës së programit në Universitetin e Arteve (UART) është një arsim i lartë gjithëpërfshirës që të plotësojë standartet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik dhe transparencës dhe të shërbejë si promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i Arsimit të Lartë me karakter artistik në Shqipëri që gëzon status të veçantë në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "*Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë*".



Në UART ofrohen programe në Muzikë, në Arte të Bukura dhe në Artet Skenike të të tre cikleve të studimit, konkretisht:

- programe të ciklit të parë të studimeve, “Bachelor”,
- programe të ciklit të dytë të studimeve, “Master i Shkencave”; “Master i Arteve” dhe “Master Profesional”.
- programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”

1.1.Përshkrimi i politikës së programit

Universiteti i Arteve përbëhet nga tre Fakultete dhe është institucioni unik në vend që ofron programe të fushave të arteve dhe që vlerëson nëpërmjet politikave të saj prurjet më të mira artistike në vend dhe në të gjithë trevat shqipfolëse.

Universiteti i Arteve aktualisht përbëhet nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë si më poshtë:

- Fakulteti i Muzikës
Departamenti Interpretimit
Departamenti Kanto
Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore
- Fakulteti i Artit Skenik
Departamenti Aktrimit dhe Teori
Departamenti Regji dhe Regji Filmi & TV
Departamenti Skenografi & Koreografi
- Fakulteti i Arteve të Bukura
Departamenti Pikturës
Departamenti Skulpturës
Departamenti Arteve të Aplikuara

Politika që mbështet UART, është në funksion të rritjes së standarteve të mësimdhënies me të gjithë komponentët përbërës, si qëllim parësor duke patur studentin dhe përafrimin e njësitimit të programeve të studimit me Universitetet në Europë.

UART mbështetet në resurset e saj akademike si dhe mbështetëse të saj.

Kjo formë e politikës së programit që mbështetet në treguesit potencial të UART, ka sjellë si rrjedhojë integrimin në mësimdhënie të stafit akademik në institucionet homologe në Evropë.

1.2. Qëllimi i politikës së programit

Qëllimi kryesor i saj është të ofrojë arsimim të lartë në tre cikle shkollimi në fushat e arteve, veprimtari krijuese dhe artistike/shkencore.



Të realizojë rritjen e standarteve të mësimdhënies me qëllim krijimin e specialistit të lartë në fushën e arteve dhe kulturës.

Kurrikula mësimore universitare të jetë objekt i rishikimit dhe përafrimit me Universitetet Evropiane të fushës së artit.

Fakultetet e Universitetit të Arteve ofrojnë programe në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, në fushën e mësuësisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programet në këtë fushë janë hartuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në Statutin e UART.

Të gjitha programet e ciklit të dytë të studimit i janë nështruar procesit të akreditimit për herë të parë të tyre. Ky proces është përmbyllur më së miri duke marrë vlerësime shumë pozitive nga Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Në UART gjatë viteve të fundit, janë hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (UMAS) 3 (tre) programe të reja studimi të ciklit të parë. Programet e reja të studimit, Bachelor, janë hapur pranë Fakultetit të Arteve të Bukura (1 program) dhe pranë Fakultetit të Muzikës (2 programe). Konkretisht, hapja e programeve të studimit sipas Urdhërave të MAS, paraqitet si më poshtë:

- Në Fakultetin e Arteve të Bukura, u hap për herë të parë programi i studimit, Bachelor në "Fotografi", me UMAS Nr 236, datë 19.07.2021 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor: në "Fotografi" në Universitetin e Arteve". Ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2021-2022, sipas UMAS. Po sipas këtij Urdhëri, Programi Bachelor në "Fotografi" i është nështruar procesit të Akreditimit të tij, pa diplomuar studentët e brezit të parë që kanë ndjekur këtë program. Vlerësimi i jashtëm, në kuadër të akreditimit të këtij programi ka përfunduar dhe UART është në pritje nga Agjencia e Sigurimit të Cilësië në Arsimin e Lartë (ASCAL) të Draft Raportit të Vlerësimit të këtij programi të hartuar nga Ekspertët e jashtëm.
- Në Fakultetin e Muzikës, u hap për herë të parë programi i studimit, Bachelor në "Perkusion", me UMAS Nr 381, datë 08.07.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në "Perkusion" në Universitetin e Arteve". Ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2022-2023, sipas UMAS. Programi i studimit është në proces të akreditimit të tij.
- Në Fakultetin e Muzikës, u hap për herë të parë programi i studimit, Bachelor në "Muzikë Jazz", me UMAS Nr 382, datë 08.07.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në "Muzikë Jazz" në Universitetin e Arteve". Ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2022-2023, sipas UMAS. Programi i studimit është në proces të akreditimit të tij.

Risi për Universitetin e Arteve është ofrimi i programeve të ciklit të tretë Doktoratë. Tashmë, të tre Fakultetet e UART ofrojnë programe Doktoratë sipas fushës së studimit të tyre. Konkretisht, hapja e programeve të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë, sipas Urdhërave të MAS, paraqitet si më poshtë:

- Në Fakultetin e Artit Skenik, u hap për herë të parë programi i studimit të ciklit të tretë, "Doktoratë në Arte Skenike", me UMAS Nr 127, datë 16.03.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Arte Skenike" në Universitetin e Arteve të Tiranës". Ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2022-2023, sipas UMAS.



- Në Fakultetin e Muzikës, u hap për herë të parë programi i studimit të ciklit të tretë, “Doktoratë në Muzikologji”, me UMAS Nr 128, datë 16.03.2022 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Muzikologji” në Universitetin e Arteve të Tiranës”. Ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2022-2023, sipas UMAS.
- Në Fakultetin e Arteve të Bukura, u hap për herë të parë programi i studimit, të ciklit të tretë, “Doktoratë në Arte Pamore”, me UMAS Nr 668, datë 05.12.2023 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Arte Pamore” në Universitetin e Arteve të Tiranës”.

1.3.Objektivat kryesore për vitet 2025-2027

Rritja e cilësisë së arsimit nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standarteve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit nëpërmjet:

- Rishikimit periodik të kurrikulave mësimore për përmirësimin e tyre dhe rritjen e standarteve me ato homologe jashtë vendit për përshtatje me nevojat e tregut të punës;
- Përmirësimin në vazhdimësi të metodës së mësimdhënie;
- Sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet zgjerimit të sistemit universitar, me Universitete të tjera në rajon dhe në Evropë duke krijuar lidhje bashkëpunimi reciproke në lëvizjen e stafëve akademike dhe të studentëve;
- Ambiente bashkëkohore, të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke krijuar mundësi praktikiteti dhe funksionaliteti me laboratorë dhe mjete të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor;
- Krijimin e laboratorëve të rinj dhe plotësimin e laboratorëve ekzistues me pajisje në ndihmë të procesit mësimor brenda kapaciteteve mbartëse si UART.
- Ndërlidhje më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës.
- Përmirësim i infrastrukturës së TI dhe shërbimeve online.
- Kërkim shkencor, veprimtari që varet nga nisma individuale, si komponent i rëndësishëm për IAL-të.
- Këshillim nga zyra e karrierës dhe sigurim të mundësive për praktikën ose punë gjatë verës dhe diplomimit.
- Sigurim të integritetit akademik dhe llogaridhënies.
- Përmirësim i statusit social- ekonomik të studentëve nëpërmjet asistencës financiare dhe shërbimeve që mund t’ju ofrohen.



1.4. Produktet kryesore që do të ofrohen në vitet 2025-2027

- 35 (tridhjetë e pesë) programe studimi për të tre Fakultetet e UART për ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe duke parë mundësinë e zgjerimit të tyre në vazhdimësi me programe të tjera të reja.
 - Fakulteti i Muzikës – 22 (njëzet e dy) programe Bsc
 - Fakulteti i Artit Skenik – 5 (pesë) programe Bsc
 - Fakulteti i Arteve të Bukura – 8 (tetë) programe Bsc
- 27 (njëzet e shtatë) programe studimi për të tre Fakultetet e UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve dhe Mësuesi.
 - Fakulteti i Muzikës – 15 (pesëmbëdhjetë) programe Master i Arteve dhe Mësuesi
 - Fakulteti i Artit Skenik – 5 (pesë) programe Master i Arteve dhe Mësuesi
 - Fakulteti i Arteve të Bukura – 7 (shtatë) programe Master i Arteve dhe Mësuesi
- 4 (katër) programe studimi për Fakultetin e Muzikës në UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional dhe Mësuesi.
- 1 (një) program studimi për Fakultetin e Muzikës në UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave dhe Mësuesi.
- 3 (tre) programe studimi të ciklit të tretë Doktoratë: pranë Fakultetit të Artit Skenik Doktoratë në “Arte Skenike”; pranë Fakultetit të Muzikës, Doktoratë në “Muzikologji” dhe pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, Doktoratë në “Arte Pamore”.
- Infrastrukturë mbështetëse e mësimdhënies e përmirësuar duke plotësuar laboratorët, sallat, klasat, atelierët dhe studiot me pajisje, mjete, lëndë të para, materiale dhe elemente të tjerë të mësimdhënies.
- Punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar sipas kërkesave të kohës dhe në përshtatje me kurikulat mësimore.

1.5. Standardet e politikës të programit Cikli i parë dhe i Dytë i studimeve

UART synon:

- Pajisjen me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UART.



- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik nëpërmjet ëorkshopeve dhe kualifikimeve të tyre artistike dhe shkencore.
- Kualifikim të stafit administrativ në vazhdimësi duke ju përgjigjur ndryshimeve të kurikulës mësimore dhe risive të kohës.

Kurrikula mësimore e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë për programet e studimit të ofruara nga UART është krijuar në mënyrë të tillë që studenti pas përfundimit të jetë:

- Një artist me integritet.
- Të jetë aktiv në të mësuarit gjatë jetës si në fushën e artit dhe në disiplina të tjera akademike.
- Një qytetar i përgjegjshëm.

Një student i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master dhe mësuesi të demonstrojë:

- Arritje të rëndësishme në fushën profesionale të zgjedhur prej tij/saj ndër disiplina të ndryshme që studiohen në Universitetin e Arteve si në njohuritë teorike ashtu dhe aftësitë performuese.
- Aftësitë profesionale të nevojshme për të ndjekur një karrierë në fushën e artit.
- Të shprehë pikëpamje të pavarura.
- Të kryejë studime kritike.
- Të zgjerojë idetë dhe të eksplorojë çështje bashkëkohore.
- Të thellojë punën krijuese.
- Të ketë rol aktiv në komunitet.
- Të jetë një përcues i mirë në mësimdhënie sipas fushës së diplomimit.

1.6.Për ciklin e tretë të shkollimit, Doktoratë

Në UART ofrohen programe të ciklit të tretë, Doktoratë, në të tre Fakultetet e tij.

Në Fakultetin e Artit Skenik, me anë të Urdhërit të MAS Nr. 127 datë 16.03.2022 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Arte Skenike”;

Në Fakultetin e Muzikës, me anë të Urdhërit të MAS me Nr. 128 datë 16.03.2022 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Muzikologji”.



Në Fakultetin e Arteve të Bukura, me anë të Urdhërit të MAS me Nr. 668 datë 05.12.2023 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Arte Pamore”.

Objektivat kryesore për ciklin e tretë të shkollimit, viti 2025-2027

1.2.

- Financim i projekteve kërkimore artistike/shkencore
- Zgjerim i aktiviteteve për përfshirjen e biznesit privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve artistike/shkencore
- Kualifikime dhe trajnime të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administratës.
- Pasurim të laboratorëve me teknologjinë bashkëkohore për mësimdhënien.

1.3. Produktet kryesore që do të ofrohen në 2025-2027

- Cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës.

2.3. Standardet e politikës të programit që duhet të plotësohen për vitet 2025-2027

- Pajisja me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UART.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Akreditimi të programeve të studimit të ofruara nga UART për të dy ciklet e studimit Bachelor dhe Master. Aktualisht ka filluar procesi i akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve.
- Mos diskriminim

Në UART studentët nuk diskriminohen nga raca, ngjyra, besimi, seksi, mosha, nacionaliteti apo origjina etnike, orientimi seksual, aftësitë fizike apo aftësi mendore apo statuset e veçanta që mund të kenë, bazuar kjo në politikën e arsimit, të pranimit, punësimit, bursave që ndjek UART dhe në ligjin e Arsimit të Lartë si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.



